

E

BIBLIOTEKA

SHETIT

854-1

K 74

GJIROKASTER


VANGJEL
KOZMA

**Nuk
ndahem
dot...**

poezi

814-1

K 94



33155

VANGJEL
KOZMA

**Nuk
ndahem
dot...**
poezi

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»



Mes ditëve
më të mira

TEJ ZGJATET RRUGA

Plepat këndojnë «Zërat e natës».
Vallëzojnë yje xixëllonjash në fllad.
Ecim mes grurit në shtegun e arës,
me shokun tim veteriner në Fushë-Arrëz.

Malet e murrmë si kapakë guaske
afrohen dhe mbyllin horizontin përbri.
Qyteti i sharrëtarëve — perlë e madhe,
në barkun e natës shkëlqeu tani.

Ecim përkrah e s'nxjerrim dot mallin.
Vesë e ndritshme na lag.
Mijëra ëndrra migjeniane ndezin
dritat në fshatrat e Pukës varg.

AI MË FLET PËR HALLET E PUNËS,
PËR BORËN E FUNDIT QË RA MBI RUDINA,
PËR QINGJAT E VEGJËL QË I DO SI FËMIJËT,
KUR VENDIN E MBUSHIN ME BLEGËRIMA.

MË FLET DHE ZËRI I NGROHTË I DRIDHET,
MALLI PËR SHOKËT VËRSHON SI PËRMBYTJE.
FILLADI I MAJIT, LEHTAS KREH PYJET
DHE SHKON I GËZUAR MALEVE TUTJE.

NË FJALËT E MIA VËRTITEN TURBINAT,
GULÇOJNË NGA PESHA MAKINAT E RËNDA.
NË QELQIN VJOLLCË TË LIQENIT TË MADH
FLOKËT BJONDË NGADALË SHPLEKS HËNA.

Jetën s'e ngrysëm në botën kuzhinë,
maçokë të shkretë tulatur pranë sobës
po malit u ngjitëm ku era të grin
dhe thinjat e para në male na dolën.

Kurrë s'u mburrëm, s'u ankuam kurrë,
Veten s'e mbajtëm se kushedi ç'bëmë.
Në kalanë e madhe që ngre socializmi
gurin tonë dhe ne po vëmë.

Eci përkrah me shokun më të mirë.
Si llambë e madhe hëna u ngrit.
Mangalli i qiellit prushëron yjtë,
tej zgjatet rruga e larë me dritë.

KTHIM NË SHTËPI

Mjegulla në lugje porsi lesh i krehur
ngrohtësi dhe dritë më shpërndanë në gji.
Në xham të kabinës kokën kam mbështetur
dhe që nga veriu kthehem në shtëpi.

Po nuk do harroj nga zhurma e qytetit
fjalët që thotë era në pyjet me fletë,
se për to kam lënë si një peng të ëmbël,
ndoshta një mendim, ndoshta zemrën vetë.

PUNËTORET E HIDRTOKALIVË

Tjetër ç'të të them
për njerëzit e mirë.

Për sondat mes dëborës dhe erës aty.
Kur shikoja duart

mbi hekurat e ngrirë,
Kisha turp të mendoja për ty.

Kisha turp të mendoja për dashurinë dhe mallin.

E di që nuk zemërohesh.

... Tani kam nevojë të hesht.

Ti krahun më hedh

dhe rritesh pranë meje

pjergull e bukur në vjeshtë.

PUNËTORËT E HIDROCENTRALEVE

Vetëm për ata është kaq e thjeshtë
të shposh tej një mal e të ngresh një të dytë
e ta mbledhësh lumin si tërkuzë të gjelbër
kur kërkon të futet mes shkëmbinjsh në grykë.

Veç ata mund të thonë duke pirë cigare;
«Këtë mal ta heqim, këtu s'është mirë.
Lumin e kalojmë poshtë në tunele
dhe në mes të shtratit ngremë malin digë».

Futen pastaj mu në zemër të tokës,
fitilat i ndezin dhe shpërthejnë minat.
Lumi i rrëmbyer i djersës së tyre
i godet me forcë dhe vërtit turbinat.

Z E M R A

Me këto përmasa kthehen në familje,
çmallen me fëmijët dhe takojnë gratë.
Duart e buta si flladet e prillit,
ledhatojnë supet si shkëmbinj të lartë.

Gjithë jetën e tyre në rendje pas dritës,
të ndjeshëm, njerëz të fortë, viganë.
Jo, nuk janë gurë ata që ngrenë digën,
zemrat dhe grushtet e tyre janë.